
	<p style="text-align: center;">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;">Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
---	---	---

Datë/a:	11.02.2020
Për/ Za/ To:	N.N.P ENG IDEA
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 10.02.2020 në ora 19:30 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “N.N.P ENG IDEA”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Konkurs projektimi për konservimin dhe adaptimin e shtepise shkolle në Muzeun e shtepive shkolla (Lagja e Herticeve, Prishtine)**”, me Nr. të Prok: 616-19-149-412 nxjerr:

V E N D I M

- I. **HEDHET POSHTË**, si e pa afatëshme ankesa e OE ankues “N.N.P ENG IDEA”, e datës: 10.02.2020 në ora 19:30 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Konkurs projektimi për konservimin dhe adaptimin e shtepise shkolle në Muzeun e shtepive shkolla (Lagja e Herticeve, Prishtine)**”, me nr. të prokurimi: 616-19-6354-423, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues.
- II. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik: **N.N.P ENG IDEA** ka bërë kërkesë për ri-shqyrtim me datë 10.02.2020 në ora 19:30.

Autoriteti Kontraktues me datë 03.02.2020 ka dërguar letren standarde për eliminim.

Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim

Ligji i Prokurimit Publik në bazë të nenit 108/A – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, par 3. i cili thekson:

“3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

3.2 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose

të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.

Operatori Ekonomik ankimor ka pranuar letrën standarde për tender te eliminuar me datë **03.02.2020**.

Njoftimi mbi vendimin e AK është publikuar me date **03.02.2020**.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 108/a par.3 dhe 3.2. OE ankimor ka lëshuar afatin ligjor (ius strictum) për të parashtruar ankesë pasi që **ka parashtruar ankesë pas orarit të punës, pas ores 16:00**.

Kalkulimin e afateve kohore e rregullon neni 5 i LPP-së.

Paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni përcaktojnë:

‘1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

2. Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj”.

Pra, sipas paragrafit 1 të nenit 5 të LPP-së, **afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe përfundojnë në një ditë pune.**

Hapja e kopjeve gjate vleresimit te ofertave është bere ne perputhje me rregullat dhe Udhëzuesin Operativ per Prokurimin Publik ku thote neni :

32.3 Tenderi do të dorëzohet te AK në një formë **të origjinalit** dhe një **numër të kopjeve** të cilat AK i ka kërkuar në mënyrë të qartë në dosjen e tenderit. Tenderi origjinal si dhe kopjet e kërkuara do të jenë identike. **Kopjet hapen ne shërbim te komisionit vlerësues.**

AK hedh poshte ankesen e parashtrua ne perrputhje me nenin 108/a i LPP-se paragrafi 8.1 cili nen percakton se:

“Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur: 8.1 kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni;


ZPP, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit te këtij vendimi.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit

ZELIë BASHKHA J

11.02.2020